



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI  
VENDIM**

**Nr. 133, Datë 06.06.2022**

**MBI**

**KËRKESËN E INSPEKTORIATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR LIDHJET E REJA NË  
SISTEMIN E SHPËRNDARJES, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.166, DATË  
10.10.2016, TË BORDIT TË ERE, E NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, pika 3, nenit 20, gërma “a” dhe nenit 27, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 104, pika 4; nenit 113, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.166, datë 10.10.2016, e ndryshuar; nenit 19 dhe 26, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/3 prot., datë 02.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve, dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, “Mbi Kërkesën e ISHTI-t për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016, të bordit të ERE”.

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 247, datë 13.12.2021, filloi procedurën mbi shqyrtimin e kërkesës së Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren e Lidhjeve të Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, i ndryshuar.
- ERE me anë të shkresës me nr.916 prot., datë 16.12.2021, dërgoi shkresën për “Marrje mendimi”, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHBS), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., KESH sh.a., Autoriteti i Konkurrencës (AK), Avokati i Popullit (AP), Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë (MFE), Shoqatës së Konsumatorit Shqiptarë, Shoqatës Shqiptare për Energjinë e Rinovueshme (AREA), Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK), Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë (CCIT), Shoqatës Konsumatori në Fokus, Biznes Albania, Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit (ZMK), Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), Bashkimit të Sindikatave të Pavaruara të Shqipërisë dhe për dijëni ISHTI-t, me anë

të së cilës u ftuan palët për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 45 ditëve nga marrja dijani e shkresës.

- Në përfundim të afateve për pritjen e komenteve dhe opinionëve, rezultoi se OST sh.a., me shkresën me nr. 11261/1 prot., datë 27.01.2022, protokolluar në ERE me nr.119/2, datë 31.01.2022, përcolli opinionin mbi këto ndryshime duke u shprehur për pikën e parë lidhur me shtimin e një dokumenti të emërtuar Vërtetim regjistrimi pranë ISHTI.
- OSSH sh.a. shprehet se ISHTI, mund të kryjë të gjitha inspektimet e nevojshme si përpara apo pas vënies në shfrytëzim të instalimeve sipas kompetencave që njeh ligji, pa ngatërruar këtë moment, me miratimin e pikës së lidhjes dhe përcaktimin e sistemit të matjes që është e drejtë ekskluzive e OSSH sh.a. Shoqëria OSSH sh.a. vlerëson se propozimi i paraqitur nga ISHTI është në kundërshtim me frymën e derregullimit dhe të lehtësimit të procedurave, ndërkohë që mund të bëhet pjesë e procedurave të brendshme të këtij institucioni, në përputhje me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat me të cilat e ka ngarkuar kuadri ligjor për inspektim, gjithashtu thekson se shtimi i elementeve të tjerë që shoqërohen me dokumentacionin e kërkuar do të ndikojë dukshëm në zgjatjen e afateve në procedurat e lidhjeve të reja.
- Po ashtu lidhur me këto propozime u shpreh dhe *Pala e interesit Z. A. M.* ku citon se: *nevoja e ISHTI-t për rregjistrim pranë saj të projektit elektrik para vënies në tension, pika 1 e kërkesës, është një hallkë e shtuar në dëm të kostove të biznesit dhe qytetarëve.* Kjo për arsyen që projekti elektrik i nevojshëm për të marrë leje ndërtimi por dhe ai i kolaudimit të sistemit elektrik depozitohet në rregjistrin e lejeve të ndërtimit bazuar në legjislacionin përkatës që rregullon aktivitetin e regjistrimit të lejeve të ndërtimit që mirëmbahet nga Agjensia e Zhvillimit të Territorit (AZHT). Bazuar në opinionin e *Palës së Interesit Z. A.M.*, alternativa e rekomandueshme për një ndryshim cilësor në rregulloren e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes dhe arritjes së përputhshmërisë me legjislacionin për ISHTI-n dhe OSSH sh.a., duke evituar hallkat shtesë përsa i takon depozitimit të projektit elektrik është ndërveprimi institucional. Riformulimi tashmë në formë tjetër e një kërkesë të propozuar nga ISHTI është një hap mbrapa në këto përpjekje dhe si e tillë, duhet të refuzohet në mënyrën që është kërkuar, për të dy pikat e saj.
- Në vijim, ERE në datën 14.02.2022, zhvilloi një seancë dëgjimore mes përfaqësuesve të ISHTI-t, OSSH sh.a., në lidhje me diskutimin për propozimet e Inspektoriatit Shtetëror teknik dhe Industrial (ISHTI), sa i përket disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren e Lidhjeve të Reja në Sistemin e Shpërndarjes” të miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, i ndryshuar, në të cilën morën pjesë të gjitha palët e njoftura.
- Shoqëria OSSH sh.a., ndau të njëjtin opinionin të shprehur nëpërmjet shkresës drejtuar ERE-s me nr.11261/1 prot., datë 27.01.2022, protokolluar në ERE me nr.119/2, datë 31.01.2022.
- Nga përfaqësuesit e ISHTI-t në këtë seancë u shpreh se propozimi i bërë në thelb konsiston në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me rregulloren e lidhjeve të reja, në mënyrë që lidhja e re të jetë e kontrolluar nga një palë e tretë që të mos jetë e njëanshme vetëm nga ana e OSSH sh.a.

- ISHT-i mund të kryejë të gjitha inspektimet e nevojshme sipas kompetencave që i njeh ligji pasi ERE nuk mund të bëjë ndryshime në rregullore për çdo rast që ndryshojnë ligjet e tjera dhe për këtë arsye e gjykojmë përmbushëse kërkesën e ISHTI-t që në këtë rregullore, në çdo rast të gjithë subjektet që aplikojnë për një lidhje të re kanë detyrimin të përmbushin kërkesat ligjore në fuqi si ato teknike apo ligjore. Parë nga ky këndvështrim, vlerësojmë që rregullorja e lidhjeve të reja duhet të pasqyrojë detyrimet nga përditesimet ligjore dhe nënligjore, duke specifikuar si akte nënligjorë ato të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave apo me Vendim të bordit të ERE-s, pa specifikuar kërkesa të veçanta që vijnë nga instucione të tjera pasi kjo do kërkonte shqyrtime apo amendime të rregullores sa herë ka amendim aktesh të tjera, ndërkohë që vetë rregullorja aktuale e lidhjeve të reja përcakton qartë kërkesat specifike për çdo kategori përdoruesish.

Për sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Tek pjesa II, “Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re”, “Për Lidhje të Reja në TU”, në pikat 2.1; 2.2; 2.3 si dhe në pragrafin “Për Lidhje të Reja në TM” shtohet nga një pikë me përmbajtje si më poshtë:
  - Si dhe çdo dokumentacion tjetër, paraqitja e të cilit bëhet e detyrueshëm nga përditësimi i akteve Ligjore dhe nën ligjore miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave apo me Vendim të Bordit të ERE-s.
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, të njoftojë Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial si dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**